

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT, me numër fiskal 603383324, në mbështetje të: nenit 17, paragrafi 5, nënparagrafi 5.8 dhe 5.13 të LIGJIT NR. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit; nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.9 dhe 1.20 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUDHËN E PËRKOHSHME, të miratuar më datë 31.12.2024, me numër protokoli 8648/24; dhe duke u bazuar në Raportin e Komisionit të Vlerësimit të datës 23.12.2025, të hartuar me Vendimin Nr. 17-BD/2025, për themelimin e Komisionit për blerje, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 24.06.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

1. **Miratohet Raporti i Komisionit të Vlerësimit** me numër protokoli 1009/2025 të datës 23.12.2025, për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme për marrje me qira të hapësirës për zyra të OIRK-së.
2. Ofertuesi **Besnik Balaj** shpallet ofertuesi fitues për shkak të ofertës më të favorshme dhe përmbushjes së kriterëve kryesore të shpalljes.
3. Autorizohet Kryetari i OIRK-së që të procedojë me nënshkrimin e kontratës me Besnik Balaj për qiramarrje të hapësirës për zyra me kohëzgjatje fillestare prej ____ viteve.
4. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikëqyrës.
- Anëtarëve Themelues të Odës.
- Arkivit të OIRK-së.

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës Komora inženjera Republike Kosovo Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo	
Njësia org. _____	Nr. i Prot. _____
Org. Jedinica _____	Org. Prot. _____
Org. Unit _____	Prot. No. _____
Nr. i faqeve _____	Data: _____
Bz. Stranica _____	Datum: 23.12.25
Nr. Pages _____	Date: _____
PRISHTINË / A	
No.1	

Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**, Kryetar i OIRK-së _____
2. **Mimoza Shahini**, Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së _____
3. **Kadri Morina**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
4. **Afrim Demiri**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
5. **Nebi Pilana**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
6. **Bujar Jupaj**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
7. **Sami Kolgeci**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____

RAPORT

i Komisionit Vlerësues për Përzgjedhjen e Hapësirës për Zyra

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK)

1. Hyrje

Me datë **10.09.2025**, Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK) ka publikuar shpalljen publike **“Kërkesë për Oferta – Hapësira të Reja Zyrash për Oden e Inxhinierëve”**, me qëllim sigurimin e një hapësire të përshtatshme për funksionimin administrativ, profesional dhe institucional të Odës.

Shpallja ka qenë e hapur për agjencitë e patundshmërive dhe pronarët e hapësirave afariste, të cilët kanë paraqitur ofertat e tyre brenda afatit të përcaktuar.

Pas mbylljes së afatit për dorëzim të ofertave, Komisioni Vlerësues ka pranuar, shqyrtuar dhe analizuar ofertat e dorëzuara, në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike.

2. Kriteret e Vlerësimit

Gjatë procesit të vlerësimit, Komisioni është bazuar në kriteret kryesore të përcaktuara në shpallje, si në vijim:

- Sipërfaqja e kërkuar: **200 – 250 m²**
- Lokacionet e preferuara: Lagjja Arbëria, Bregu i Diellit, Rruga B, Rruga C, Lagjja Pejton, Lagjja Emshir
- Qasje e lehtë për anëtarësinë dhe lidhje me transportin publik
- Mundësi për organizim funksional të zyrave individuale dhe kolektive
- Salla takimesh dhe hapësira pritjeje
- Ndriçim dhe ventilim natyral
- Infrastrukturë teknike (energji, internet, ngrohje/ftohje), me preferencë për ngrohje me Termokos
- Siguri (hyrje e kontrolluar, sistem alarmi)
- Mundësi parkimi
- Çmimi i qirasë dhe raporti kosto-përfitim

3. Ofertat e Pranuara dhe Analizuara

Komisioni ka pranuar dhe analizuar këto oferta:

Oferta nr. 1

- **Ofertues:** Kujtim Sfirca
- **Lokacioni:** Lagjja Emshir
- **Sipërfaqja:** 100 m² + 35 m² (të bashkueshme)
- **Sipërfaqja totale:** 135 m²



**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

- **Çmimi:** 750 € / muaj (pa përfshirë taksat)
- **Çmimi për m2:** 5.55 €

Vlerësim:

Kjo ofertë nuk plotëson kriterin minimal të sipërfaqes prej 200 m² të përcaktuar në shpallje dhe për këtë arsye nuk është marrë në konsideratë për fazën përfundimtare të vlerësimit.

Oferta nr. 2

- **Ofertues:** Besnik Balaj
- **Lokacioni:** Rruga B
- **Sipërfaqja:** 212 m²
- **Çmimi:** 1,200 € / muaj + tatimet
- **Çmimi për m2:** 5.66 €

Vlerësim:

Oferta plotëson kriteret e sipërfaqes, lokacionit të preferuar, qasjes së lehtë për anëtarësinë, organizimit funksional të hapësirës, infrastrukturës teknike dhe ngrohjes me Termokos.

Oferta nr. 3

- **Ofertues:** Leart Binaku
- **Lokacioni:** Dragodan
- **Sipërfaqja:** 222 m²
- **Çmimi:** 2,000 € / muaj
- **Çmimi për m2:** 9.00€

Vlerësim:

Oferta plotëson kriterin e sipërfaqes dhe lokacionit, por ka kosto dukshëm më të lartë krahasuar me ofertën nr. 2.

Oferta nr. 4

- **Ofertues:** Leart Binaku
- **Lokacioni:** Rruga B (afër Maxi 24)
- **Sipërfaqja:** 208 m²
- **Çmimi:** 2,500 € / muaj
- **Çmimi për m2:** 12.02 €

Vlerësim:

Edhe pse plotëson kriteret teknike dhe të lokacionit, kjo ofertë ka çmim shumë të lartë në raport me ofertat e tjera.

Oferta nr. 5

- **Ofertues:** Arbër Kololli

- **Lokacioni:** Dragodan
- **Sipërfaqja:** 230 m²
- **Çmimi:** 2,760 € / muaj
- **Çmimi për m²:** 12.0 €

Vlerësim:

Oferta plotëson kriterin e sipërfaqes, por paraqet koston më të lartë ndër të gjitha ofertat e pranuar.

5. Analiza Krahasese

Pas analizës së detajuar të të gjitha ofertave, Komisioni konstaton se:

- Oferta nr. 2 ofron raportin më të favorshëm kosto–përfitim
- Plotëson të gjitha kriteret kryesore të shpalljes
- Ndodhet në një nga lokacionet më të preferuara (Rruga B)
- Siguron qasje të mirë për anëtarësinë dhe vizitorët
- Ka infrastrukturë teknike të përshtatshme dhe ngrohje me Termokos
- Ka çmim dukshëm më të ulët krahasuar me ofertat tjera që plotësojnë sipërfaqen e kërkuar

6. Rekomandimi i Komisionit Vlerësues

Duke u bazuar në kriteret e shpalljes publike, analizën teknike dhe financiare të ofertave, si dhe interesin institucional të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, Komisioni Vlerësues rekomandon Bordit Drejtues të OIRK-së që të përzgjedhë ofertën nr. 2, të paraqitur nga Besnik Balaj, për marrje me qira të hapësirës për zyra.

Raportit i bashkëngjiten:

- Të gjitha ofertat e pranuar
- Dokumentacioni përcjellës
- Fotografitë e hapësirave të ofruara

Prishtinë, 23.12.2025

Komisioni Vlerësues:

Emri dhe Mbiemri Nënshkrimi

Arsim Rapuca

Afrim Demiri

Bujar Jupaj

